


Në kuadër të mbështetjes që partnerët ndërkombëtarë i kanë dhënë Parlamentit Shqiptar, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI) po zbatojnë projektin 4 vjeçar "Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri" me mbështetjen e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

## Objektivat kryesore të projektit:



## Pritshmëritë:



Administrata e Kuvendit i përmbush funksionet e saj në mënyrë efikase.



Parlamenti përmirëson funksionet e tij legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese me anë të përfaqësimit më të mirë të elektoratit, si dhe duke i kërkuar llogari ekzekutivit.



Qytetarët bëhen pjesë e zhvillimeve demokratike në vend dhe përgatiten që t'i mbajnë deputetët përgjegjës dhe të ushtrojnë ndikim te reformat.

## Partnerët ofrojnë mbështetjen e tyre në fushat e mëposhtme:

### OSBE



### NDI

- Administrata e Kuvendit funksionon në një kornizë të përmirësuar të kuadrit rregullator të brendshëm.
- Parlamenti përdor një sistem të integruar dhe transparent për procesin ligjberës duke lehtësuar aksesin në arkivat parlamentare, punën në distancë dhe online (e-Legislation).
- Deputetët të përmirësojnë njohuritë mbi ushtrimin e funksioneve të tyre ligjberëse, si dhe përdorin instrumente dhe mjete të cilat i lehtësojnë ato.
- Parlamenti nxit pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje duke promovuar njohuritë e tyre mbi çështjet parlamentare dhe proceseve demokratike përmes medias.

- Deputetët marrin një shërbim më cilësor përmes rritjes së kapaciteteve të shërbimeve të administratës së Kuvendit (Shërbimi i Kërkimit, Bibliotekës, Medias/Marrëdhënieve me Publikun, Botimet Parlamentare dhe Sektorin e Projekteve)
- Kuvendi themelon Institutin Parlamentar, i cili do të ofrojë produkte cilësore kërkimore, analitike dhe edukuese.
- Kuvendi themelon Shërbimin e Edukimit Qytetar dhe ndërton një Qendër Vizitorësh shumë funksionale, në kuadër të Institutit Parlamentar.
- Kuvendi promovon standardet më të larta të transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në bashkëpunimin me shoqërinë civile.